



### **Znj. Nina Guga**

Zv. Ministre e Arsimit

**Kur përgatitej projekt-buxheti për vitin 1921-22, At Gjergj Fishta përgatiti një ligjëratë për reformën arsimore në Shqipëri, të cilën s'e mbajti dot pasi parlamenti u shpërnda, por u botua në Hyllin e Dritës. Ndër të tjera ai thekson se ndër kombe të qytetëruara shkolla, bashkia dhe tempulli përbëjnë trilogjinë epike të të qytetërimit e të përparimit shoqëror. Shkolla, si përfaqësuese e perfeksionit individual e kolektiv të njeriut, shprehje e të gjithë përparimit moral e material të tij.**

**Edhe rekomandimet e kapitullit 26, tashmë që procesi i screening ka filluar synojnë ndër të tjera të promovojë bashkëpunimin brenda kornizës së politikave të përbashkëta si rritja e cilësisë së arsimit, dialogu kulturor, ruajtja e pasurisë kulturore, trashëgimia e përbashkët kulturore dhe për të forcuar dhe mbështetur aktivitetet e bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare.**

[Video](#)

**Qeveria shqiptare, edhe në kuadër të procesit të negociatave ka prioritet arsimin dhe gjithëpërfshirjen në edukim. Për këtë janë hartuar edhe një sërë strategjish, si strategjia kombëtare e arsimit, strategjia e punësimit, strategjia e rinisë, strategjia e sportit, strategjia e ndërkombëtarizimit etj.**

**Hapat që ka bërë dhe po bën Shqipëria në lidhje me kapitullin e 26-të të GNPIE “Arsimi dhe Kultura”**

**Përshëndetje i nderuar Imzot Angelo Massafra,**

**I nderuar Prof. Dr Jan De Groof,**

**E nderuar motër Teuta,**

**Të nderuar pjesëmarrës,**

**Kënaqësi të jem sot pjesë e konferencës tuaj “Kultura e pluralizmit dhe gjithëpërfshirjes në edukim”, si pjesë e panelit 2 ku do të diskutojmë mbi “Rolin e pluralizmit kulturor në ndërtimin e identitetit evropian të Shqipërisë”. Si përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe në rolin e negociatores për kapitullin 26 “Arsimi dhe Kultura” fjala ime i referohet hapave që ka bërë dhe po bën Shqipëria në lidhje me këtë kapitull.**

**Aktualisht vendi jonë është në një moment shumë të rëndësishëm dhe po punon për tu bërë pjesë e familjes së madhe evropiane. Të gjithë anëtarët e grupeve të punës dhe institucionet kontribuese, kanë punuar dhe vijojnë të punojnë për të përmbushur të gjitha rekomandimet/kërkesat e KE në mënyrë që të bëhemi sa më shpejt pjesë e BE.**

**Në muajn tetor 2022 u zhvillua takimi shpjegues për kapitullin 26 “Arsimi dhe Kultura” ku përfaqësuesit e këtij kapitulli morën udhëzimet nga ekspertët e KE mbi acquis e BE dhe përafrimin e saj me legjislacionin shqiptar.**

**Pas këtij takimi u bë një punë intensive për përgatitjen e takimit bilateral që ishte një nga takimet më të rëndësishme, ku institucioni jonë shpjegoi në mënyrë të detajuar gjithë punën që është bërë në 5 vitet e fundit në fushën e arsimit, sportit, arsimit profesional, rinisë dhe kulturës. Për takimin bilateral, i cili u mbajt më 27 prill 2023 u përgatit kontributi për 54 pyetje të ardhur nga KE sipas fushave të caktuar si dhe u përgatitën 11 prezantime, me tematikat:**

- **Politikat e Shqipërisë në fushën e kulturës**
- **Politikat dhe sistemi arsimor në Shqipëri**
- **Arsimi fillor dhe i mesëm shqiptar**
- **Arsimi i lartë shqiptar**
- **Politikat për akses në arsim dhe trajtim të barabartë**
- **Politikat dhe sistemet e AFP-së në Shqipëri**



**Znj. Nina Guga**  
Zv. Ministre e Arsimit

- **Kuadri kombëtar i kualifikimeve të Shqipërisë**
- **Bashkëpunimi në Programet e BE-së në mbështetje të Arsimit dhe AFP-së ERASMUS+**
- **Politikat dhe sistemet rinore në Shqipëri**
- **Politikat e Shqipërisë në fushën e sportit**
- **Antikorrupsioni në arsim, rini, sport dhe kulturë**

**Në përfundim të takimit ekspertët e KE vlerësojnë punën e bërë nga delegacioni shqiptar, duke theksuar se përpjekjet dhe arritjet në këto fusha janë në drejtimin e duhur, sipas acquis së BE.**

**Momentalisht jemi në pritje të raportit të KE mbi prezantimin e kapitullit në takimin bilateral për të parë rekomandimet me të cilat duhet të punojmë në vijmësi.**

**Dua të theksoj se Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në përafrimin e legjislacionit me standardet e BE-së, në të gjitha fushat e përgjegjësisë për Kapitullin 26: arsimit, sportin, arsimin profesional, kulturën dhe rininë.**

**Më lejoni të ndalem më specifikisht të disa prej arritjeve kryesore që janë bërë në kudo të kapitullit 26.**

**Bazuar dhe në rekomandimet e KE janë miratuar dhe po zbatohen strategjitë e mëposhtme:**

- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021 – 2026 dhe Plan i saj i Veprimit;**
- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 dhe Plan i Veprimit për zbatimin e saj si dhe plani i zbatimit të garancisë rinore 2023-2024;**
- Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 dhe Plan i saj i Veprimit;**
- Strategjia Kombëtare e Kulturës 2019-2025 dhe Plan i saj i Veprimit.**

**Në fushën e arsimit të lartë një nga prioritetet e MAS është Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë, në kuadër të së cilit në vendin tonë është hapur për herë të parë Kolegji i Evropës. Kjo është një arritje e madhe në këtë proces dhe synon të rrisë cilësinë në Arsim, si dhe të suportojë procesin e integritetit të Shqipërisë në BE.**

**Në fokusin e politikave të MAS është agenda evropiane 2021-2030 e cila vendos prioritetet bashkëkohore për ndryshimet globale që po ndodhin si:**

- **Përmirësimi i cilësisë, barazisë, përfshirjes dhe suksesit për të gjithë në arsim dhe trajnim;**
- **Të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe lëvizshmëria për të gjithë;**
- **Rritja e kompetencave dhe motivimit në profesionin e arsimit;**
- **Përforcimi i arsimit të lartë evropian;**
- **Mbështetja e tranzicionit të gjelbër dhe digjitalizimit nëpërmjet arsimit dhe trajnimit**

**Së fundmi është publikuar dhe progress raporti, i cili vjen çdo vit nga KE me rekomandimet dhe arritjet për kapitullin 26.**



**Znj. Nina Guga**  
Zv. Ministre e Arsimit

**Shkurtimisht bazuar në këtë progress raport dua të theksoj se kapitulli 26 ka bërë arritje në:**

**- politikën kundër korrupsionit**

**- në arsimin gjithëpërfshirës, rritja e regjistrimeve të fëmijëve me AK**

**- miratimi i ligjit për arsimin parauniversitar, duke përfshirë dispozita për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe për shndërrimin e shkollave speciale në qendra burimore**

**- rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin parauniversitar**

**- miratimi i Strategjisë kombëtare për të rinjtë 2022-2029 në tetor 2022 etj.**

**Sigurisht që ka ende politika për tu përmirësuar në përmbushje të rekomandimeve të ardhura si:**

**1. optimizimi i sistemit të AFP-së në përputhje me nevojat e fuqisë punëtore të tregut;**

**Punë e cila ka nisur si bashkëpunim MAS-MFE - është hartuar udhëzuesi për këshillimin e karrierës për klasat 6 dhe 9 dhe po vijon fushata promovuese e AFP “Zgjidh Zanatin”**

**2. përmirësimi i zhvillimit profesional dhe trajnimit të mësuesve dhe trajnerëve, me fokus në aftësitë pedagogjike që lidhen me zbatimin e qasjes gjithëpërfshirëse të bazuar në kompetenca dhe dixhitalizimin nga niveli parafillor në atë universitar, duke përfshirë arsimin e AFP-së;**

**MAS ka në fokus një trajnim kombëtar të mësuesve në STEM (kompetenca digjitale) dhe përgatitjen për testet ndërkombëtare.**

**3. miratimi i legjislacionit zbatues për Ligjin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.**

**Komisioni Evropian ofron mbështetje për kapitullin 26 me projekte të ndryshme si:**

• **EU for social inclusion & EU for teaching**

• **Në kuadër të dy projekteve janë realizuar Workshop sensibilizuese për gjithëpërfshirjen, mbështetje në drejtim të përmirësimit të infrastrukturave fizike të punonjësve sociale, trajnime, mbështetje për qendrat burimore**

• **Eu for social inclusion: Assistencë teknike**

• **Eshtë realizuar një raport për reformimin e Komisioneve Multidisiplinare**

• **EU for Social inclusion mbështetje buxhetore**

• **MAS raporton rregullisht për indikatorët që lidhen me nr e psikologëve dhe punonjësve socialë dhe nxënësit me AK**

• **Erasmus**

• **Takime rrjetëzuese, vizita studimore, shkëmbim i përvojave dhe praktikave të mira, partneritete arsim-biznes, trajnime profesionale, krijimi i komuniteteve të qëndrueshme mjedisore.**

• **Gjithashtu nëpërmjet mbështetjes së AADF janë ndërtuar 100 Smartlabs në 100 shkolla dhe këtë vit me mbështetjen e Bankës Botërore po ndërtohen 216 SmartLabs në 200 shkolla. Ky projekt do të zgjerohet dhe në 500 shkolla të tjera me mbështetjen e CEB.**

**Puna jonë do vijoj për të arritur atë që është qëllimi jo vetëm i MAS por i të gjithë shqiptarëve, ai i Integritit të vendit në BE. Duke u bërë pjesë e familjes së madhe evropiane ne do të kontribuojmë me kulturën dhe identitetin tonë kombëtar si një vlerë e shtuar në fushën e edukimit.**